




REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Assembly
JUNIK

Rregullorja Komunale Nr: 10/2010

NGA:

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCA



RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË PËR VITIN 2011

JUNIK
Shtator, 2010

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03L/0-40, nenit 12.2 pika c, mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut 2003/29, neni 4.1, të datës 5.09.2003, dhe Statutin e Komunës neni 20. Kuvendi Komunal i Junikut në mbledhjen e vet të mbajtur me datë: 29.09.2010, aprovoj këtë:

RREGULLORE MBI TATIMIN NË PRONË

Neni 1.

1.1. Duke u bazuar në Nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 baza tatimore do të caktohet si më poshtë:

Sipas Zonave në bazë të vlerës së tregut në m²

Zona	Lokal afarist	Apart-mentet	Shtëpi	Garazh	Objekte Industri.	Objekte Bujqso.	Objekte Të pa Përfunduara	Pishina noti dhe Terene sportive
I	500 €	350 €	350 €	150 €	250 €	150 €	120 €	120 €
II	400 €	270 €	270 €	100 €	200 €	100 €	100 €	120 €
III	300 €	200 €	200 €	50 €	150 €	50 €	80 €	100 €
IV	200 €	150 €	150 €	20 €	100 €	20 €	40 €	100 €

Neni 2.

2.1 Duke u bazuar në vend ndodhjen e pasurisë e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj në Komunën e Junikut janë përcaktuar 4 zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

Neni 3.

3.1. Zona e parë

Përfshin të gjitha objektet që kanë dalje në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale, ku përfshin rrugën nga Qendra e Junikut e deri te ura e shkollës fillore, rruga nga Qendra e Junikut deri te rruga e mullirit të Çokut, rruga nga Qendra e Junikut e deri te stacioni policor, rruga nga Qendra e Junikut (rruga për Dobrosh) e deri te udhëkryqi i rrugës së Berishës dhe rruga nga Qendra e Junikut e deri te Ura e Erenikut.

3.2. Zona e dytë

Përfshinë hapësirën në të dy anët e rrugës magjistrale dhe lokale pas përfundimit të zonës së parë sipas nenit 3.1. dhe përfshin: rruga nga shkolla deri ne Voksh, nga rruga e mullirit të Çokut deri në Rastavicë, nga rruga e udhëkryqit te Berishës deri në Dobrosh, dhe rruga nga ura e Erenikut deri në Batushë dhe objektet tjera të banimit në lagjet: Gacafer, Pepsh, Bajraktar, Hoxhë, Berishë, Miroc, Krasniq, Gaxherr i Ulët dhe i Epërm, Shalë, Malok, Qestaj dhe lagjja Agim Ramadani - e cila dallon nga zona industriale.

3.3 Zona e tretë

Përfshinë të gjitha hapësirat të cilat nuk janë të përfshira në zonën e I – rë dhe te II – të, e qe i përkasin Qytetit te Junikut: lagja Goçaj dhe objektet tjera të banimit të cilat gjinden në periferi të lagjeve të cekura në zonën e dytë.

3.4 Zona e katërt përfshinë:

Të gjitha hapësirat jashtë Qytezës së Junikut: fshatrat Gjocaj, Jasiq.

Neni 4.

4.1 Në pajtim me neni 6 të Rregullores së UNMIK-ut, 2003/29 normat tatimore te tatimit në prone për pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2011 për Komunën e Junikut janë siç vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e indeksit
1.	Prona Komercale	0.20%
2.	Prona industriale	0.15%
3.	Prona rezidenciale /private/	0.10%
4.	Pishinat dhe fushat sportive	0.15%
5.	Prona bujqësore	0.05%

Neni 5.

5.1. Pronat të cilat lirohen nga tatimi në prone e të cilat janë të cekura ne nenin 7 të Rregullores 2003/29, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Junikut.

Neni 6.

6.1 Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të behet konform nenit 15 pika 1 të Rregullores së UNMIK_ut, 2003/29 .

Neni 7

7.1 Në pajtim me nenin 10.2 të Rregullores 2003/29 mbi përgjegjësitë komunale, dhe Udhëzimit Administrativ 11/2003 neni 1. Kryetari i komunës së Junikut emëron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve për vitin 2011 .

Neni 8.

8.1 .Rregullorja e UNMIK-ut, 2003/29 e datës 05 shtator 2003 mbi “Tatimin e Pronës te Paluajtshme në Kosovë” rregullon të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në prone e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 9.

9.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe e njëjta do të zbatohet për vitin 2011.

KUVENDI I KOMUNËS JUNIK

Data: 29.09.2010
Nr. 10/2010



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Sinan Gacaferi